



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 gusht 2024
Nr. ref.: RK 2515/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI183/23

Parashtrues

Bujar Hoti

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit Rev.nr.239/23, të 31 korrikut
2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Bujar Hoti me vendbanim në fshatin Polac, Komuna e Skenderaj (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [Rev.nr.239/23] e 31 korrikut 2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në ndërlidhje me Aktvendimin [Ac.nr.416/21] e 4 majit 2023, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktvendimin [Cnr.257/2019], e 17 dhjetorit 2020, të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega e Gjykatës në Glllogoc, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Rev.nr.239/23] të 31 korrikut 2023, të Gjykatës Supreme. Parashtruesi nuk ka cekur asnjë shkelje të pretenduar të neneve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 5 shtator 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 15 shtator 2023, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës së Supreme.
7. Më 18 shtator 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KI 183/23] e caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KI 183/23] Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci (anëtarë).
8. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
9. Më 26 qershor 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Nga shkresat e lëndës, rezulton se parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar në ish ndërmarrjen shoqërore “Feronikeli” që nga viti 1984 deri më 1997, në punët dhe detyrat e inxhinierit të elektros.
11. Më 17 korrik 2006, parashtruesi i kërkesës lidhi kontratë të punës me pasardhësin e kësaj ndërmarrjeje, “NewCo Feronikeli L.L.C” (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi), e cila marrëdhënie pune vazhdoi deri më 1 mars 2013, kur i ishte shkëputur ajo përmes

- Vendimit [nr. prot. 72] me arsyetimin se i ka skaduar kohëzgjatja e kontratës dhe se punëdhënësi nuk kishte nevojë më për parashtruesin e kërkesës.
12. Më 7 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi për kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e pagave kundër punëdhënësit në Gjykatën Supreme.
 13. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 13 qershor 2019, Gjykata Supreme ia dorëzoi në kompetencë Gjykatës Themelore shqyrtimin e kërkesëpadsisë së lartcekur.
 14. Më 15 tetor 2020, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C.nr.257/2019] i kërkoi parashtruesit të kërkesës precizimin e kërkesëpadsisë së 7 qershorit 2019.
 15. Më 20 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi precizimin e padsisë së tij në Gjykatën Themelore.
 16. Më 23 tetor 2020, punëdhënësi parashtrroi përgjigje në padinë e parashtruesit të kërkesës, me ç'rast e kundërshtoi atë me arsyetimin se e njëjta është paraqitur jashtë afatit ligjor.
 17. Më 17 dhjetor 2020, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C.nr.257/2019] hodhi poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës si të pasafatshme, me arsyetimin si në vijim: *“Meqenëse paditësi [parashtruesi i kërkesës] ka pasur mundësi që të paraqesë kërkesë tek i padituri dhe nëse e paditura ne afatin prej 15 ditë nuk ka vendosë në kërkesën e tij, i njëjti është dashur që të paraqesë padi në afatin prej 30 ditë nëse nuk ka qene i kënaqur me vendimin e të paditurës ose ka qenë i pa kënaqur por paditësi padinë e tij e ka paraqitur me vonese sepse nëse llogarisim nga data 01.03.2013 kur paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës rezulton se padia e paditësit është paraqitur me vonesë prej 6 viteve e 3 muaj dhe 6 ditëve.”*
 18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë kundër Aktvendimit [C.nr.257/2019] të 17 dhjetorit 2020 të Gjykatës Themelore.
 19. Më 4 maj 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [A.c.nr. 416/2021] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e lartcekur të Gjykatës Themelore.
 20. Më 24 maj 2023, parashtruesi i kërkesës parashtrroi revizion kundër Aktvendimit [A.c.nr. 416/2021] të 4 majit 2023 të Gjykatës së Apelit.
 21. Më 31 korrik 2023, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev.nr.239/23] refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se: *“[...] i ka vlerësuar me kujdes pretendimet e paditësit të paraqitura në revizion, mirëpo të njëjtat janë të pabazuara, për faktin se afatet e përcaktuara me nenin 78 dhe 79 të Ligjit të Punës, janë afate prekluzive, dhe të njëjtat afate nuk mund të zgjaten dhe as të shtyhen, në rast të kalimit, padia është gjithmonë e pasafatshme, pa marrë parasysh arsyet e lëshimit të afatit.”* Tutje, Gjykata Supreme në arsyetimin e saj theksoi se parashtruesi i kërkesës e ka parashtruar padinë e tij pas kalimit të afatit ligjor dhe rrjedhimisht padia në këtë rast është e palejuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës pretendon se i janë cenuar përmes Aktvendimit të kontestuar. Në këtë drejtim, ai vetëm përmend shkeljen e neneve 78 (Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit) dhe 79 (Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë) të Ligjit Nr. 03/L-2012 të Punës (në tekstin e mëtejme: Ligjin e Punës), dhe në lidhje me këtë thekson si në vijim: *“Përcakton se punëdhënësi duhet brenda 15 ditëve tu përgjigjet kërkesave për kthim në punë, fletore x-o, fq. 8, 9, 10 prandaj brenda 1 viti që e përcjella sakt se mos po na kthejn në pun, nuk e di që ju ka përgjigj ndokujt. Të gjitha institucionet i pat blloku me ndihmsat hajna shqiptarë [...]. Në pjesën tjetër të kërkesës, parashtruesi shpjegon kronologjinë e punësimit të tij si dhe akuzon punëdhënësin e tij për keqpërdorime të ndryshme.*

Dispozita relevante ligjore

LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS

Neni 78 (Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit)

“1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës.”

Neni 79 (Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë)

“Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.”

Neni 87 (Afati i parashkrimit)

“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.”

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 391 (pa titull)

*“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se:
[...]
f) padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj;
[...].”*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
24. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

25. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.”

26. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Rev.nr.239/23], e 31 korrikut 2023, të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Në këtë aspekt, kërkesa e parashtruesit të kërkesës përmbushë kriteret e përcaktuara me paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
27. Më tutje, në vlerësimin nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me ligj, Gjykata duhet t'i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parashtruesve të kërkesave kushtetuese ua përcakton specifikisht detyrimin që në kërkesat tyre drejtuar Gjykatës Kushtetuese të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendojnë se u janë cenuar. I njëjti kriter është i përcaktuar edhe në

pikën d të paragrafit 1 të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, i cili kërkon që kërkesat e paraqitura në Gjykatën Kushtetuese të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese. Të njëjtat kriteret, Gjykata do t'i analizojë më poshtë.

28. Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës kishte punuar te punëdhënësi i tij deri më 7 mars 2013. Më 7 qershor 2019, ai parashtroi padi për kthim në vendin e punës dhe kompensimin e pagave, të cilën kërkesëpadi e refuzoi Gjykata Themelore me arsyetimin se ishte paraqitur më shumë se 6 (gjashtë) vite pas afatit ligjor. Si rezultat i kësaj, parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, të cilën ankesë, e njëjta ia refuzoi si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore. Kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi parashtroi revizion, të cilin Gjykata Supreme e refuzoi me të njëjtin arsyetim, përkatësisht, se ishte paraqitur jashtë afatit ligjor të paraparë në Ligjin e Punës.
29. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës para Gjykatës nuk specifikon të drejtat kushtetuese e as nenet përkatëse të Kushtetutës, të cilat konsideron se i janë shkelur përmes vendimeve gjyqësore të ndërmarra në rastin e tij, por në kërkesën e tij vetëm përmend disa nene të Ligjit të Punës, shkeljen e të cilave nuk e arsyeton. Ai në kërkesën e tij vetëm shpjegon kronologjinë e punësimit të tij si dhe akuzon ish punëdhënësin e tij për keqpërdorime të ndryshme.
30. Gjykata thekson se për të konsideruar që një kërkesë plotëson kriteret e pranueshmërisë, parashtruesi i kërkesës është i detyruar që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri, të garantuara me Kushtetutë, i janë cenuar dhe në mënyrë adekuate të paraqesë faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese (shih në këtë kontekst rastet e Gjykatës, [KI91/17](#), parashtrues *Enver Islami*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 nëntorit 2018, paragrafi 31; [KI206/19](#), parashtrues *Mladen Nikolić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 26 shkurtit 2019, paragrafi 33; si dhe shih rastin [KI97/20](#), parashtrues *Nehat Salihu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 26 marsit 2021, paragrafi 54, [KI73/21](#), parashtruese *Minire Krasniqi Zhitia*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 korrikut 2021, paragrafi 39).
31. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet në një mënyrë me vendimet e gjykatave të rregullta, marrë parasysh faktin që të njëjtit i është refuzuar padia e tij për kthim në vendin e punës dhe kompensim të pagave me arsyetimin se padinë e kishte paraqitur jashtë afatit ligjor. Megjithatë, parashtruesi nuk ka qartësuar se cilat të drejta dhe liri, të garantuara me Kushtetutë, pretendon se i janë cenuar dhe ai ngritë pretendime të përgjithësuara pa saktësuar të drejtat kushtetuese të cilat ai pretendon se i janë cenuar dhe pa qartësuar faktet që arsyetojnë pretendimet konkrete.
32. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kjo nuk është e mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 34 (1) (d) dhe (2) të Rregullores së punës. Përfundimisht, Gjykata konstaton që kërkesa është e papranueshme në baza kushtetuese në kategorinë e pretendimeve “*të pambështetura dhe të paarsyetuara*”.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenet 20, 47 dhe 48 të Ligjit, rregullit 34 (1) (d) dhe (2), si dhe rregullit 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 26 qershor 2024,

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

Gjyqtari raportues


Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani